



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-111/01-0080332/21

Dt. 15/09/2021

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 53 paragrafi 1 dhe 3, neni 56 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 77 të Statutit të Komunës, si dhe bazuar në Vendimin nr. 01/35, dt; 12.09.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për Masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID 19, Rekomandimet e IKSHPK-së, për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID 19, Kryetari i Komunës, sjellë:

V E N D I M

(për anulimin e procedurave të rekrutimit)

1. ANULOHET procedura e rekrutimit për konkurset, si në vijim;

- Konkursi nr. 07-111/01-0063213/21, i dt.02.08.2021, ShML- Mësimdhënës/e për lëndën bazat e së drejtës dhe e drejta (12 orë mësimi);
- Konkursi nr. 07-111/01-0063215/21, i dt.02.08.2021, ShML- Mësimdhënës/e për kor/orkestër;
- Konkursi nr. 07-111/01-0063218/21, i dt.02.08.2021, ShML- Mësimdhënës/e për gjuhë frënge (14 orë);
- Konkursi nr. 07-111/01-0063220/21, i dt.02.08.2021, ShML- Mësimdhënës/e për gjuhë angleze;
- Konkursi nr. 07-111/01-0063225/21, i dt.02.08.2021, ShML- Mësimdhënës/e për fizikë;
- Konkursi nr.07-111/01-0063227/21, i dt.02.08.2021, ShML- Mësimdhënës/e për filozofi, Zëvendësim ;
- Konkursi nr.07-111/01-0063228/21 Datë.02.08.2021, ShML- Mësimdhënës/e për edukatë fizike, Zëvendësim;
- Konkursi nr. 07-111/01-0061825/21, i dt.28.07.2021, ShF- Mësimdhënës/e mbështetës/e, Zëvendësim;
- Konkursi nr.07-111/01-0061821/21, i dt.28.07.2021, ShF- Mësimdhënës/e për ciklin klasor;
- Konkursi nr. 07-111/01-0061825/21, i dt.28.07.2021, IP - Edukatorë mbështetës, Zëvendësim;
- Konkursi nr. 07-111/01-0061824/21, i dt.28.07.2021, IP - Edukatore për grup-moshat 3- 6 vjeç;
- Konkursi nr. 07-111/01-0061826/21, i dt.28.07.2021, ShF - Mësimdhënës/e për ciklin klasor Zëvendësim;
- Konkursi nr. 07-111/01-0061822/21, i dt.28.07.2021, IP - Edukatore për grup-moshat 0 - 3 vjeç;
- Konkursi nr. 07-111/01-0063212/21, i dt.02.08.2021, ShML- Mësimdhënës/e për lëndën anatomi dhe edukatë shëndetësore;



- Konkursi nr. 07-111/01-0063209/21, i dt.02.08.2021, ShML- Mësimdhënës/e për lëndën patalogji;
- Konkursi nr. 07-111/01-0063206/21, i dt.02.08.2021, ShML- Mësimdhënës/e për matematikë (12 orë) në gj.boshnjake;
- Konkursi nr. 07-111/01-0063204/21, i dt.02.08.2021, ShML- Mësimdhënës/e për psikologji, Zëvendësim;
- Konkursi nr. 07-111/01-0063203/21, i dt.02.08.2021, ShML- Mësimdhënës/e për sociologji, Zëvendësim;
- Konkursi nr. 07-111/01-0063200/21, i dt.02.08.2021, ShML- Mësimdhënës/e për lëndën morfologjia e dhëmbit;
- Konkursi nr. 07-111/01-0063199/21, i dt.02.08.2021, ShML Mësimdhënës/e për lëndën sëmundjet e dhëmbit dhe gojës;
- Konkursi nr. 07-111/01-0063195/21, i dt.02.08.2021, ShML- Mësimdhënës/e për sociologji (10 orë);
- Konkursi nr. 07-111/01-0063343/21, i dt.03.08., ShMU- Mësimdhënës/e për edukatë figurative;
- Konkursi nr. 07-111/01-0063344/21, i dt.03.08.2021, ShMU- Mësimdhënës/e për edukatë fizike;
- Konkursi nr. 07-111/01-0063347/21, i dt. 03.08.2021, ShMU- Mësimdhënës/e për biologji;
- Konkursi nr. 07-111/01-0063350/21, dt. 03.08.2021, ShMU- Mësimdhënës/e për matematikë (16 orë mësimi në gjuhën boshnjake);
- Konkursi nr. 07-111/01-0063354/21, i dt.03.08.2021, ShMU- Mësimdhënës/e për matematikë (12 orë mësimi në gjuhë turke);
- Konkursi nr. 07-111/01-0063332/21, i dt.03.08.2021, ShMU- Mësimdhënës/e për histori, Zëvendësim;
- Konkursi nr.07-111/01-0063337/21, i dt. 03.08.2021, ShMU- Mësimdhënës/e për kimi;
- Konkursi nr. 07-111/01-0063341/21, dt.03.08.2021, ShMU- Mësimdhënës/e për kimi, Zëvendësim;
- Konkursi nr. 07-111/01-0063345/21, i dt.03.08.2021, ShMU- Mësimdhënës/e për matematikë;
- Konkursi nr.07-111/01-0063349/21, i dt.03.08.2021, ShMU-Mësimdhënës/e për piano (obligat) korepetitor;
- Konkursi nr. 07-111/01-0063353/21, i dt. 03.08.2021, ShMU- Mësimdhënës/e për piano;
- Konkursi nr.07-111/01-0063355/21, i dt.03.08.2021, ShMU- Mësimdhënës/e për TIK;
- Konkursi nr. 07-111/01-0063396/21, i dt.03.08.2021, ShMU-Mësimdhënës/e për gjuhë angleze, Zëvendësim;
- Konkursi nr.07-111/01-0063390/21, dt.03.08.2021, ShMU-Mësimdhënës/e për gjuhë gjermane – vend i lirë;
- Konkursi nr. 07-111/01-0063391/21, i dt.03.08.2021, ShMU- Mësimdhënës/e për gjuhë Shqipe – Zëvendësim;
- Konkursi nr.07-111/01-0063333/21, i dt. 03.08.2021, ShMU- Mësimdhënës/e për histori
- Konkursi nr. ShMU Mësimdhënës/e për gjuhë Shqipe - vend i lirë;
- Konkursi nr. 07-111/01-0063338/21, i dt.03.08.2021, ShMU- Mësimdhënës/e për gjuhë gjermane – Zëvendësim;



- Konkursi nr. 07-111/01-0063339/21, i dt.03.08.2021 ShMU- Mësimdhënës/e për gjuhë angleze - Vend i lirë;
 - Konkursi nr.07-111/01-0063340/21, i dt.03.08.2021 ShMU- Mësimdhënës/e për gjeografi (10 orë) Zëvendësim;
 - Konkursi nr.07-111/01-0063342/21, i dt.03.08.2021 ShMU- Mësimdhënës/e për fizikë - Vend i lirë.
2. Konform dispozitave ligjore në fuqi, një shpallje e re e rekrutimit, për të gjitha konkurset e lartpërmendura, do të pëgatitet në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara ligjore.
 3. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

A r s y e t i m

Bazuar në faktin se situata epidemiologjike në Kosovë sipas Raporteve të fundit të IKSHPK-së është mjaft e rënduar, masat për ruajtjen e shëndetit publik dhe mbrojtjen nga Covid – 19 janë dëshmuar si mëse të domosdoshme për të parandaluar përhapjen e mëtejme të Pandemisë Covid-19.

Me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik, si dhe parandalimin e shpërndarjes së Covid-19, pasojat e të cilit jemi duke i përjetuar për kohë të gjatë, me theks të veçantë numrin e madh të rasteve të infektuar, numrin e madh të rasteve të vdekjeve në veçanti periudhës së fundit, përfshirë këtu edhe territorin e komunës së Mitrovicës, jemi të obliguar dhe të përkushtuar që në proporcion me rreziqet e shkaktuara nga Covid – 19, të ndërmmarrim masa të përshtatshme me rrethanat e kohës dhe vendit.

Përkundër faktit që një numër i konsiderueshëm i qytetarëve janë vaksinuar madje edhe me dy doza me vaksinën anti-covid, numri i qytetarëve të pavaksinuar ende vazhdon të mbetet mjaft i madh. Kjo bënë që situata me pandeminë Covid-19 të vazhdon të mbetet e rëndë, kapacitetet shëndetësore gjithnjë e më të ngarkuara, masat e shtuara të kufizimeve në fusha dhe sektorë të ndryshëm, kanë bërë që të afektohet jashtëzakonisht shumë edhe jeta dhe mirëqenia e përgjithshme e qytetarëve edhe në komunën tonë.

Aktualisht, të gjitha institucionet në vendin tonë janë të obliguara që të punojnë me stafin esencial, përderisa pjesa tjetër e stafit obligohet të punojë nga shtëpia. Gjithashtu, në procesin e rekrutimit ku numri i kandidatëve është i lartë, sikurse fusha e arsimit dhe shëndetësisë, nga praktika e punës me palë kemi kuptuar se mbajtja dhe respektimi i distancës fizike është problem shumë serioz, për të mos thënë i pamundur. Ndërsa, numri vogël i nëpunësve (staf esencial) si dhe shfrytëzimi i hapsirave me kapacitete të reduktuara praktikisht nuk siguron mbarëvajtje të mirë dhe të rregullt të procesit, me theks të veçantë mbajtja e testeve me shkrim, intervistave, etj, ngase vetëm sa krijon paknaqësi dhe jo transparencë tek aplikuesit dhe e bënë të pamundur zhvillimin e procedurave në mënyrën e tyre të sigurtë dhe të rregullt.

Zhvillimi i procedurave të rekrutimit sipas procedurave ligjore, siç janë mbajtja e testit, për një numer kaq të madh të aplikuesve, jo që nuk garanton, por rrezikon seriozisht shëndetin publikë, kur kemi parasyshë faktin që kemi rreth 600 aplikues që kanë aplikuar në të gjitha konkurset, si në atë të shëndetësisë primare, arsimit dhe në administratën komunale, e që ende ka konkurse të hapura.

Përveq kësaj, zhvillimi i procedurave të rekrutimit, siç janë mbajtja e testeve dhe intervistave, në kohën kur jemi në prag të fushatës zgjedhore, për mbajtjen e zgjedhjeve lokale të 17 tetorit 2021, mund të krijoj me të drejtë pakënaqësi tek qytetarët, e me theks të veçantë të të gjithë atyre që kanë aplikuar për punësim.

Vlerësojmë se anulimi i procedurave të rekrutimeve është poashtu i arsyeshëm për faktin se i gjithë aktiviteti mësimor në institucionet e arsimit parauniversitar, madje edhe institucionet e arsimit parashkollor (çerdhe të fëmijëve) është pezulluar, madje janë ndaluar edhe të gjitha organizimet dhe aktivitetet tjera jashtë mësimore sikurse ekskursionet, shetitjet grupore, ahengjet e ndryshme të stafit mësimor apo nxënësve. Të gjitha këto organizime dhe aktivitete sigurisht se sjellin grumbullime të njerëzve duke bërë kështu gjithnjë e më të lartë rrezikun e shpërndarjes së infeksionit me Covid-19, e me këtë edhe përkeqësimin e mëtejshëm të gjendjes në përgjithësi.

Vlenë të theksohet se anulimi i procedurave të rekrutimit bëhet në fazën fillestare të konkurseve, pasi që nuk është themeluar asnjë komision i cili është përgjegjës për zhvillimin e procedurave të rekrutimit, si në konkurset për personel shëndetësor, personel arsimor, si dhe në personelin e administratës komunale.

Prandaj, me qëllim të zbatimit sa më të efektshëm të masave për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë Covid-19 dhe ruajtjes së shëndetit publik, si dhe me qëllim që të ndikojmë dhe të kontribuojmë në përmirësimin e vazhdueshëm të situatës epidemiologjike në vend dhe arsyeve tjera të përmendura, bazuar në dispozitat ligjore të lartcekura, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

I dërgohet:

- 1x1 Zyrës së Personelit
- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Drejtorisë së Arsimit
- 1x1 Arkivës

